

Përgatiti Ben Andoni



Shkrimtari Alberto Moravi

Nga Anna Maria de Dominicis & Ben Johnson*

Vijon

...”Korpasi kryesor i letërsisë narrative është, pas të gjithash, kritika e një forme apo e një tjetre. Në Itali, kur themi diçka, si p.sh e mrekullueshme- kjo mbahet si fjala e fundit: Italianët pëlqejnë më shumë bukurinë sesa të vërtetën. Arti i romanit, po ashtu, është i lidhur me rritjen dhe zhvillimin e borgjezisë evropiane. Italia ende nuk e ka një borgjezi moderne. Është e vërtetë që Italia është një vend shumë i vjetër; dhe në shumë mënyra duket si i ri sepse është kaq shumë i vjetër. Kulturalisht, ajo tani ndjek pjesën tjetër të Evropës; bën atë që bënin të tjerët më parë, por është vonë. Një gjë tjetër, në historinë tonë të letërsisë, është se ka shumë shkrimtarë-titanë-por jo shumë mesatarë mes tyre syresh. Petrarka shkroi në shekullin e katërbëdhjetë, dhe pastaj për katër shekuj çdokush që erdhi më pas thjesht u mundua ta imitojë. Bokaçio i shteri komplet mundësitë e tregimit të shkurtër italian në shekullin e katërbëdhjetë. Shekujt tonë të artë ishin atëherë, kur gjuha e letërsisë sonë ekzistonte dhe po atëbotë edhe u kristalizua...”

Gjithsesi, ndërsa është ende duke u redaktuar *Nuovi argomenti*, ju duket se shikoni fillesën e një pjese të madhe të letërsisë së re?

“Sa do të dëshiroja ta bëja! Shkrimtarët italianë janë përtacë. Në tërësi, kam pritur shumë pak. Të marrim simpoziumin tonë mbi artin komunist. Na u premtuan plot njëzetë e pesë punë (referate) të mëdha. Dhe, sa mundëm të gjenim të tilla syresh? Vetëm të imagjinosh-tre. Realisht është një barrë e madhe të bësh një review në Itali. Ajo, që ne kemi nevojë dhe nuk e gjejmë më janë letërsia dhe esetë politike të gjata, nga njëzetë deri në tridhjetë faqe. Ne marrim shpesh pamflete nga katër faqesh-dhe pesë faqesh plot urrejtje; të vetmet që nuk do donim të kishim, në fakt”.

Por kam ndërmend fikshën. Duke e redaktuar *Nuovi argomenti*, ju du-

het që të kuptoni më shumë tani rreth fikshën-it italian modern në përgjithësi dhe shumë më tepër sesa e pranoi në të vërtetë.

“Jo. S’është krejt e besueshme kjo. Unë di vetëm për ata shkrimtarë që i njeh gjithkush. Përveç, kësaj nuk duhet të lexoni gjithçka për të ndërjerë se çfarë ju pëlqen. Nuk do të emëroja ndonjë emër të veçantë; sepse do të kishte boshllëqe dhe gafa të tmerrshme”.

Si e llogarisni hapësirat e mëdha boshe në traditën e romanit në Itali? A mund të na rrëfeni pak për romanin në Itali?

“Kjo është një pyetje shumë e stërmadhe, apo jo? Por, do të përpiqem t’ju përgjigjem. Mendoj se dikush mund të thotë që Italia dikur e kishte pasur një roman, duke u kthyer në të shkuarën. Kur borgjezia ishte borgjezi, pra në shekujt e trembëdhjetë dhe katërbëdhjetë, rrëfimi është zhvilluar i plotë (duhet që të kujtoni se edhe piktura, gjithashtu, është po kaq narrative) por që nga koha e Kundër-Reformacionit, shoqëria italiane duket se nuk e shikon më veten në pasqyrë. Korpasi kryesor i letërsisë narrative është, pas të gjithash, kritika e një forme apo e një tjetre. Në Itali, kur themi diçka, si p.sh e mrekullueshme- kjo mbahet si fjala e fundit: Italianët pëlqejnë më shumë bukurinë sesa të vërtetën. Arti i romanit, po ashtu, është i lidhur me rritjen dhe zhvillimin e borgjezisë evropiane. Italia ende nuk e ka një borgjezi moderne. Është e vërtetë që Italia është një vend shumë i vjetër; dhe në shumë mënyra duket si i ri sepse është kaq shumë i vjetër. Kulturalisht, ajo tani ndjek pjesën tjetër të Evropës; bën atë që bënin të tjerët më parë, por është vonë. Një gjë tjetër, në historinë tonë të letërsisë, është se ka shumë shkrimtarë-titanë-por jo shumë mesatarë mes tyre syresh. Petrarka shkroi në shekullin e katërbëdhjetë, dhe pastaj për katër shekuj çdokush që erdhi më pas thjesht u mundua ta imitojë. Bokaçio i shteri komplet mundësitë e tregimit të shkurtër italian në shekullin e katërbëdhjetë. Shekujt tonë të artë ishin atëherë, kur gjuha e letërsisë sonë ekzistonte dhe po atëbotë edhe u kristalizua. Anglia dhe Fran-

Moravio: “Prusti dhe Xhojsi e shfarosën letërsinë”

Kjo pjesa e fundit e Intervistës së Alberto Moravisë. Ai rrëfen censurën, raportin e personazhit të vetës së parë dhe të tretë për një krijues, si edhe mendimin për letërsinë italiane.

ca kanë pasur shekujt e tyre të artë, kuptohet shumë më vonë. Merrni, për shembull, Danten. Dantja shkroi në një italishte të pastër, që është ende shumë e kuptueshme. Por bashkëkohësi i tij Chaucer shkroi me një gjuhë tepër të zhvilluar: Sot, veçse, ai praktikisht duhet të përkthehet për lexuesit modernë. Kjo është arsyeja pse shumë shkrimtarë modernë italianë nuk janë shumë italianë dhe u duhet të shikojnë jashtë vendit për mjeshtrat e tyre: Me pak fjalë: tradita e tyre ka mbetur tepër pas këtu, është gati mesjetare. Madje, në dhjetë vitet e fundit, ata kanë filluar të shikojnë drejt Amerikës për drejtuesit e tyre”.

A mund të na rrëfeni diçka rreth pjesës tuaj *Racconti romani*?

“Nuk ka shumë gjëra që mund t’ju them për të. Ato përshkruajnë klasat e ulëta romane dhe borgjezinë e vogël në një periudhë të veçantë pas luftës”.

Kjo është e gjitha? Dua të them, nuk ka ndonjë gjë tjetër që mund të shtoni?

“Çfarë mund të shtoj? Po, jo..., në të vërtetë-në të vërtetë ka shumë pak, nga ajo që dua të them. Vetëm se ka gjithmonë shumë nga ajo që mund të them rreth botimeve të mia të fundit. Më bëj pyetje dhe do t’ju përgjigjem për çfarëdo gjëje që do të më pyesni”.

Që të jem i sigurtë. Kam lexuar vetëm një nga ato. Nuk e shikoj zakonisht *Corriere della Sera* dhe libri vetë më duket pak si i shtrenjtë...

“Njëzetë e katër mijë lira”.

Në ndonjë rast, ju nuk keni qenë deri më tani... ose të paktën jo shpesh, keni pasur lidhje me klasat e ulëta ose borgjezinë e vogël. Këto histori duken si një ikje e pastër nga puna juaj e mëparshme. Ndoshta ju mund të thoni diçka rreth ndonjë problemi në veçanti që ju përballeni duke e shkruar.

“Secili nga librat e mi është rezultat, nëse nuk është parashikuar, i mendimeve të thella të cilat janë të përfshira në vepër. Në shkrimin e *Racconti romani* kishte probleme specifike, ku duhej t’i bëja ballë-problemit të gjuhës. Më lër të arsyetohet në këtë mënyrë: Sipas *Racconti romani* të gjithë punët e mia kanë qenë shkruar në vetën e tretë, edhe kur, si p.sh në *La Romana* dhe pastaj-në romanin që sapo kam mbaruar-flitet thjesht në vetën e parë. Me anë të përdorimit të vetës së tretë-dua të them se... thjesht arrin që të shprehet me një stil të mbështetur letrar, stili i vetë autorit. E kam shpjeguar këtë, meqë ra fjala, në një shënim që

është bërë në botimin e *Penguin* të *The Woman of Rome*. Në *Racconti romani*, nga ana tjetër, adoptova për herë të parë në vepër gjuhën e karakterit, gjuhën e personit që flet në vetën e parë; por atje sërish, jo gjuha në mënyrë të drejtpërdrejtë, por thjesht *tonaliteti* i gjuhës. Kishte avantazhe dhe dis-avantazhe në marrjen e këtij ushqimi. Avantazhe për lexuesin në faktin ngaqë ai mund ti lejonte vetes tashmë një intimitet më të madh; ai futej direkt në thellin e gjërave; nuk qëndronte jashtë duke përgjuar. Metoda ishte në thell fotografike. Disavantazhi i madh i vetës së parë konsiston në kufizimet e llahtarshme imponuar në atë çfarë ka thënë në vepër vetë autori. Në këtë rast, mund të sjell atë që subjekti vetë do donte të sillte, të flas vetëm për atë që subjekti mund të flasë. Unë, personalisht, jam i kufizuar dhe më tej në faktin e thjeshtë: një shofer taksie nuk mund të flasë me ndonjë njohuri të madhe qoftë dhe për punën e një rrobalarëse, kurse në vetën e tretë- unë mund t’ia lejoj vetes të flas për çfarëdo që të dëshiroj. Adriana, *Gruaja e Romës*, flet në vetën time të tretë;madje, mund të flasë për ndonjë gjë tjetër në Romë njësoj si të jetë vetvetja ime, dhe gjithashtu edhe një banor Roman i zakonshëm mund të flasë njësoj.

Përdorimi i trajtës së vetës së parë në trajtimin e klasave të ulëta romane nënkupton, natyrisht përdorimin e dialektit. Dhe, përdorimi i dialektit nënkupton kufizime të rrepta për materialin e dikujt. Madje edhe Belleri, mjeshtri i *Romanesque*, mund të flasë për gjëra të vërteta, por është i kufizuar për të folur për të tjerët. Klasat punëtore janë ngushtësisht të kufizuara në zgjedhjen e tyre për t’u shprehur dhe personalisht nuk jam thjesht i predispozuar në përdorimin e dialekteve në letërsi. Dialekti është një formë inferiore e shprehjes sepse është një formë më pak e kultivuar. Ai mund të ketë aspektet e tij magjepsëse, por mbetet i ashpër, shumë më i papërpunuar sesa vetë gjuha. Në dialekt dikush shpreh kryesisht dhe këtë fare mirë, nevojat primare dhe nevojat më të domosdoshme-të ngrënë, të fjeturit, të pirët, të bërët dashuri dhe kështu me radhë.

Në *Racconti romani* -ka gjashtëdhjetë e një shprehje në volum, megjithëse kam shkruar më shumë se njëqind prej tyre deri tani. Ato janë zgjidhja ime kryesore për të ardhurat-gjuha e folur është italishtja, por ndërtimi i fjalisë është i parregullt dhe ka këtu-atje zgjidhje me një fjalë ras-

tësore në dialekt, që bëhet thjesht për të kapur nuancat e gjuhës së përditshme, aromën dhe vrullin e *romanesco*. Është i vetmi libër në të cilin jam përpjekur të krijoj karaktere komike të historive-në një kohë kur secili mendonte se nuk kisha fare sens humori.

Jam përpjekur në këto histori, siç kam thënë, të përshkruajetën e proletariatit të ulët dhe *tres petite bourgeoisie* në një periudhë fill pas luftës së fundit. *Picaro* është një karakter, që jeton ekskluzivisht si një qenie ekonomike, arketipi i Marksit, për atë që flitej se gjëja e parë fillon nga stomaku: ngrënia. Nuk ka dashuri, dashuri të vërtetë romantike; e mbi të gjitha, është i vetmi që i imponohet faktit që ai duhet të hajë apo të tretet. Për këtë arsye, *Picaro* është gjithashtu një qenie jo aq interesante. Jeta e tij është e lidhur me dredhinë, mashtrimin, pandershmërinë nëse ju e mendoni siç duhet. Jeta me ndjenjën dhe me gjuhën e ndjeshmërisë, fillon në një stad më të ngritur”.

Temat kanë një rrugë që duket se bëjnë periodicitet përgjatë punës suaj.

“Patjetër. Natyrisht. Në punën e secilit shkrimtar, në konstruktin e punës së tij për të rrëfyer përpjekjet e tij, do të gjeni tema periodike. Personalisht i shikoj romanet e mia si një roman i vetëm- ashtu si është i gjithë korpasi i një shkrimtari, sikur të jetë një kompozim muzikor në të cilin karakteret janë tema, nga variacionet në variacione duke e kompletuar në fund një parabolë të tërë. Kështu është ngjashëm me gjithë temat në vetvete. Kjo ngjashmëri e kompozimit muzikor... më vjen në mend tani për tani. Mendoj, sepse i tillë është edhe afrimi im në këtë materie; kurrë nuk është i kalkuluar dhe para skicuar, është disi instiktiv duke u përpunuar me vesh dhe mbetur ashtu si ka qenë”.

Dhe, një libër i fundit tani. Ne nuk mund të diskutojmë për të gjitha. Por a mund të na rrëfeni diçka rreth *La mascherata*? Kjo dhe fakti sesi u kalua nga censura.

“Ah, tashti që ju e përmendni më vjen ndërmend: ka qenë një kohë kur isha shumë i dhënë në shkrimin e gjërave sociale. Gjithsesi, mbeti e vetmja kohë. Më 1936, shkova në Meksikë dhe një skenë hispaniko-amerikane më dha impulsin e idesë së një satire. Iu ktheva dhe për disa vjet luajta me këtë ide. Atëbotë, më 1940 shkova në Kapri dhe atje e shkrova. Se çfarë ndodhi paskëta...ju po më pyesni për censorët-është një histori vërtetë zbatimëse. (Vijon në faqen 18)

Koha Kalendar



Nga Aleksandër Isajević Sollzhenicin *

Njerëzit e harruan Perëndinë, që këtu vijnë të gjitha!

Këtu e gjysmëshekulli më parë, kur isha ende fëmijë, dëgjova nga shumë të moshuar që shpjegonin tërmetet e mëdha që tronditën Rusinë, se: "Njerëzit e harruan Perëndinë, që këtu vijnë të gjitha!" Qysh atëherë jam marrë gati gjysmëshekull me studimin e revolucionit tonë, kam lexuar qindra libra, kam mbledhur qindra dëshmi vetjake, kam shkruar tetë vëllime për ta pastuar vendin nga gërmadhat; dhe, po të më kërkohet tani të formuloj sa më shkurt shkaku madhor të këtij revolucioni shkretues që na ka ngrënë afro 60 milionë njerëz, nuk do të mund të bëja diçka më të mirë, sesa të përsëris: Njerëzit E harruan Perëndinë, që këtu vijnë të gjitha!

Por ka edhe diçka: ndodhitë e revolucionit rus nuk mund të kuptohen në ditët tona në këtë fundshekull, përveçse në sfondin e atyre që kanë ngjarë në vendet e tjera. Por atëherë përvijohet një proces universal. Po të më kërkohet të përshkruaj shkurtimisht dallojen kryesore të këtij shekulli, edhe një herë nuk do të mundja të gjeja përgjigje më të saktë e më thelbësore se sa: "Njerëzit E harruan Perëndinë!"

Duke i munguar maja hyjnore, ndërgjegjia njerëzore zhbëhet dhe ky perversion përcak-

toi krimet e mëdha të këtij shekulli, duke filluar me të parin e tyre: Luftën e Parë Botërore, ku e ka burimin pjesa dërrmuese e rrethojave të sotme. Kjo luftë që i panë sytë një Evrope plot energji, të begatë e të lulëzuar e që u gremis në çmendurinë e vetëshqyerjes duke shkallmuar kësajoj të ardhmen e saj për më se një shekull, madje përgjithmonë, kjo luftë, pra, është duke u harruar. Por kjo luftë nuk mund të shpjegohet përveçse nëpërmjet një erësimit të përgjithshëm të asyres të udhëheqësve të atëhershëm, të cilët e humbën nocionin e një Fuqie Supreme, sipër tyre. Vetëm ky tërbim i çmendur që harroi Zotin, mundi t'i bëjë shtete në dukje të krishterë të përdorin gaze kimike në një mënyrë aq barbare. Një përvetim identik i vetëdijes njerëzore, pa majën e vet hyjnore, mundësoi pas Luftës së Dytë Botërore rënien në grackën djallëzore të "ombrellës bërthamore". Thënë ndryshe: të heqim dorë nga çdo gjë, ta zhveshim rininë

nga çdo detyrë e përgjegjësi, të mos bëjmë asnjë përpjekje për të mbrojtur të tjerët, të dyllosim veshët që të mos dëgjojmë rënkimet që vijnë nga Lindja, të përfshihemi në garën e çmendur të mirëqenies dhe, në rast se kërcënimi do të qëndrojë mbi kokat tona, atëherë do të na mbrojnë bomba atomike - në se jo, gjithë bota në djall të vejë! Dobësia mjerane në të cilën e ka poshtëruar veten Perëndimit i sotëm, vjen në radhë të parë nga ky gabim fatal: nga besimi se mbrojtja e botës nuk varet prej forcës së zemrave dhe as prej guximit të njerëzve, por vetëm e vetëm prej armëve bërthamore.

U desh që Perëndimi të humbë në fillim kuptimin sipëror të Hyjnore që të mund të ndihmonte pa iu dridhur dora pas Luftës së Parë Botërore në agoninë e ngadaltë të Rusisë së bërë copa-copa nga një bandë kanibalësh, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore - në shkatërrimin e Evropës Lindore. Emëgjithatë, këtu zuri fill procesi i gjatë i rënimit të



Shkrimtari disident, rus, Aleksandër Isajević Sollzhenicin

botës mbarë: Perëndimi nuk e kuptoi këtë, madje ndihmoi edhe vetë. Vetëm një herë gjatë këtij shekulli Perëndimi i bashkoi forcat e veta: për t'iu kundërvënë Hitlerit. Por frytet e kësaj fitoreje janë shterur prej shumë kohësh. Në luftën me antropofagët, ky shekull pa shpirt fetar sajoi një metodë anestezike: tregtinë! Ja deri në ç'larësi ngrihet sot mençuria jonë!

Po qe se do të mund t'u tregonim shekujve pararendës pragu që ka për të prekur bota në ditët tona, do të jehonte një klithmë e njëzëshme: "Ky është Apokalipsi!" Por ne jemi mësuar me të, madje kemi rënë në ujdje me të.

Dostojevski pat paralajmëruar: "Mund të vijnë ngjarje të rëndësishme, të cilat do t'i gjëjnë të papërgatitura forcat tona intelektuale". Kjo edhe ndodhi. Dhe po ai pat parashikuar: "Bota do të shpëtohet vetëm pasi të jetë vizituar nga shpirti i keq". Që do të shpëtohet, kjo duhet parë. Shpëtimi do të varet

nga ndërgjegjia jonë, nga përparimi ynë në maturi, nga përpjekjet individuale e të përbashkëta përballë një gjendjeje katastrofike. Një ka ndodhur tanimë: shpirti i së keqes lëviz ngadhënjyes duke ligëruar gjerë e gjatë në të pesë kontinentet tanë.

Jemi dëshmitarë të rënimit të botës: disa vende këtë rënim e kanë pësuar, në të tjera shihet qartë. Krejt shekulli XX po gremiset në grykën e vorbullës së ateizmit e të vetshkatërrimit. Kjo rënie në humerë vesh veçori globale që nuk varen as nga sistemet politike e as nga niveli i ekonomisë, as nga veçantitë kombëtare. Aq pak e ngjashme në dukje me Rusinë e vitit 1913, Evropa ndodhet buzë së njëjtës gremine, por ajo ka mbërritur këtu përmes një udhe tjetër. Pjesë të ndryshme të botës kanë ndjekur rrugë të ndryshme, por të gjitha po mbërrijnë në pragu e një shkatërrimi të përbashkët.

Dikur edhe Rusia pat njohur kohëra historike në të cilat shoqëria nuk kishte si ideal as

(Vijon nga faqja 17)

Të paktën, argëtuese më duket tani. Ishte viti 1940. Ne ishim në rrjedhën e plotë të luftës: Fashizmi, censura, e të tjerë e të tjerë. Dorëshkrimi i kontrolluar njëherë, si të gjithë dorëshkrimet e tjera, duhet që të paraqitet pastaj në Ministrinë e Kulturës Popullore të merrte aprovimin. Kjo ministri, më lini që t'ju shpjegoj mirë, ishte e mbushur me mësuesit e shkollës-fillore që mermin nga tremijë lireta, që shkojnë rreth gjashtë apo shtatë mijë në kohët tona, për çdo libër që lexonin. Dhe, patjetër, për të ruajtur qoshet e tyre, kurdo që ishte e mundur ata ta kthenin mbushur me gjykime negative. Mirë, ja që unë e dorëzoja dorëshkrimin. Por, cilido që e lexonte, nuk mund që të merrte ndonjë pozicion në libër, sepse duhej kaluar drejt sekretarisë; pastaj sekretaria e ministrit; ministrin vetë, dhe përfundimisht tek Musolini".

Hamendësoj, atëherë, që jeni thirrur para Panelit?

"Jo aspak. Musolini ishte ai që urdhëroi që të botohej libri".

Oh!

"Dhe kjo ishte e vërteta. Megjithatë, një muaj më vonë, mora një komunikim të pakonfirmuar që më informonte se libri ishte tërhequr. Dhe kjo ishte kjo... që po ndodhte. Libri nuk u shfaq sërish edhe pas lirimit".

Ishte kjo- e vetmja paraqitje juaja tek censorët?

"Oh, jo, jo... pa asnjë lloj kuptimi! Kam qenë për një kohë të gjatë, gati për një kohë jetësore Antifashist. Ka pasur një luftë ndërmjet meje dhe autoriteteve fashiste që filloi më '29 dhe mbaroi me okupimin gjerman më 1943, kur mu desh që të ikja dhe të fshihesha në male, afër frontit të jugut, dhe ku kam pritur gati nëntë

muaj derisa erdhën Aleatët. Atë kohë, librat e mi nuk lejoheshin as që të përmendeshin në shtyp. Shumë herë me urdhër të Ministrisë së Kulturës, kam humbur punët që kisha nëpër gazeta dhe për shumë vjet u detyrova të shkruaja nën Penname **Pseudo**.

Censura është një gjë e dhimbshme! Dhe një bimë që dreqin... mezi mbillet ndodh që zë rrënjë! Ministria e Kulturës ishte e fundit që e mbylli aktivitetin e saj. I dërgova *Agostino* vetëm dy muaj para se të binte Fashizmi, vetëm dy muaj para fundit të Luftës. Ndërsa e gjitha situata rreth tyre ishte përmbytur, kishte rënë apo dhe ishte shkatërruar krejt, Ministria e Kulturës Popullore vazhdonte njësoj punën e saj. Aprovimi dukej se nuk do bëhej. Kështu që, një ditë, Unë shkova vetë atje në Via Veneto-ju e njihni këtë vend; ata janë sërish andej, rastësisht mbase; i njihja të gjithë ata-të shikoja se çfarë i pengonte për botimin e kësaj. Ata më thanë se kishin frikë dhe se nuk ishin të gatshëm të më jepnin aprovimin për librin. Dosja ime qëndronte e hapur në tavolinë dhe kur sekretari la dhomën për një moment- u zgjata që t'i hidhja një sy. Kishte një letër nga një atashe kulture brazilian në të, disa poetë, që informonin ministrin se në Brazil unë isha i konsideruar si subversiv. Në Brazil, në të gjitha vendet! Por kjo letër, e vetme, ishte e mjaftë që mua të më ndalonin publikimin e librave. Një tjetër kohë-kjo i shkollon kohës për *Le Ambizioni sbagliate* -kur shkova gjeta dorëshkrimin e shpërndarë kudo në hapësirë, në disa zyra të ndryshme me një numër njerëzish të ndryshëm që lexonin pjesë të tij! Censura ishte monstruoze, një gjë monstruoze! Mund t'ju rrëfej



të gjitha se çfarë doni të dini për të. Ata filluan, çuditërisht pak si më shumë liberalë në fillim. Por me kohën, ata u bënë më të këqij. Përveçse e mbushën ministrinë me mësues të shushatur, vetë censorët ishin ose burokratë ose shkrimtarë të paaftë; dhe vetëm qielli mund të ndihmonte nëse libri do të binte në duar të

këtyre 'shkrimtarëve!'"

Si është puna për shkrimtarët sot? Ju thoni se censura është "ende këtu".

"Shkrimtari nuk duhet të trembet për asgjë. Ai mund të publikojë çfarëdo që dëshiron. Po kështu është në kinema dhe në teatër, kudo ku mund të jetë arti".

Çfarë mund të na thuash për *Indexin*?

"Indexi nuk është në të vërtetë censurë, të paktën në Itali. Vatikani është një gjë dhe Italia ishte tjetra, dy shtete të ndara dhe krejt të veçanta. Nëse do të vinte në fuqi në Itali, ose nëse do ishte sërish për të fituar fuqinë, kjo do mund të ndodhte në Irlandë apo në Spanjë, atëherë po që kjo do të ishte vërtetë serioze".

Dikush mund të ketë menduar, mbase nga revolta juaj kur jeni zëvendësuar në *Index*, se ju e vlerësonit atë si një përmbledhje të lirisë suaj si shkrimtar?

"Jo, s'është kjo. Në të vërtetë isha i shkatërruar, por më shumë sepse edhe nuk më pëlqejnë skandalet".

Gjithsesi, kjo mund t'i ketë shtuar shitjet tuaja. Atëbotë, kujtoj se ka qenë Bompiani që filloi nxjerrjen e veprave tuaja të zgjedhura në botime luksoze.

"Jo, në Itali *Index* nuk ndikoi në shitje në një mënyrë apo në tjetër. Unë jam shitur gjithnjë mirë dhe nuk pati ndonjë rritje më shumë në shitjet dhe pas çështjes së *Index*".

Ju nuk e shikoni mundësinë që Italia të bjerë në një sistem të ri totalitar?

"Ka një mundësi, por kjo është krejt e largët. Nëse do të vi puna për një sistem të ri totalitar, shkrimtarët, me atë që besoj sot është se do të kenë mbështetje, ose thjesht do të ndër-

presin së bashku të shkruarit".

Rastësisht, çfarë mendoni për të ardhmen e romanit?

"Hëm, romani me atë që njohim nga shekulli i nëntëmbëdhjetë është shfarosur krejt nga Prusti dhe Xhoisi. Ata ishin nga të fundit në shekullin e nëntëmbëdhjetë-që ishin shkrimtarë të mëdhenj. Duket qartë tani se ishim duke shkruar drejt *roman a idee* apo drejt një romani dokumentar- apo të ashtuquajturit romani i ideve (patjetër romani i jetës si shkon më mirë tashmë), me karaktere të ngritura dhe jo psikologjik. Është e dukshme po ashtu që një romani i mirë mund të jetë i ndonjë farë lloji, por të dy format që janë tashmë të përhapura janë romani-ese dhe romani dokumentar apo ai që kam nga eksperiencia personale, *quelque chose qui arrive*. Jeta ka marrë dy rrugë në kohën tonë: turmën dhe intelektualët. Dita e turmës është e gjitha rastësore; dita e intelektualëve është e gjitha flozofike. Tashmë, nuk ka borgjezi, vetëm turmë dhe intelektualë".

Çfarë mund të na thoni "për letërsinë si skandal", që ka lidhje me Francën?

"Hëm, kjo shkon që nga koha e viteve '30 (shekulli XX), koha kur ato skandalizonin njëra-tjetrën".

Dhe në punën tuaj, a e shikoni dot një drejtim të ri?

"Do të vazhdoj duke shkruar romane dhe tregime të shkurtra".

Ju nuk e parashikoni dot kohën, atëherë, ku do ta kaloni mëngjesin tuaj ndryshe?

"Unë nuk do e parashikoj dot kohën, kur do ndiej se nuk kam asgjë për të thënë"

Përktheu nga anglishtja Ben Andoni

Fjala e mbajtur me rastin e marrjes së Çmimit Templeton, në Pallatin Buckingham, më 10 maj 1983. Ky Çmim, i krijuar më 1972 nga John Templeton dhe që i jepet për vit një personaliteti, i cili shquhet në përhapjen më tej të besimit të krishterë, për herë të parë iu akordua një ortodoksi, pra A. I. Solzhenicini

pasurinë e as armitjet materiale, por shenjërmin e jetës. Rusia e atëherëshme ushqej nga Ortodoksia që i kishte mbetur besnikë Kishës primare të shekujve të parë. Kjo Ortodoksi e ndëruar diti ta mbronte popullin pavarësisht nga dy apo tre shekuj zgjedhe të huaj dhe, në të njëjtën kohë, të hidhte poshtë sulmet e ulëta të kryetarëve shpatëmbajtës të Perëndimit. Në ato kohëra besimi ortodoks brumte mendësinë, karakterin dhe sjelljen e njerëzve, strukturat familjare, jetën e përditshme, kalendarin, njëpasnjëshmerinë e punëve në shkallë jave e viti. Besimi bashkonte kombin dhe çimentonte fuqitë e tij. Por në shekullin XVII Ortodoksia jonë fatkeqësisht u bre nga një përçarje e brendshme. Ndërsa në shekullin XVIII Rusia mbarë u tronditi nga reformat tiranike të Pjetrit të Madh, që mbytytën shpirtin fetar dhe jetën kombëtare, në dobi të ekonomisë, të shtetit e të luftës. Me arsimimin në një drejtim të vetëm, të imponuar nga Pjetri i Madh, edhe ne u prekëm nga filladi dinakërisht i helmët i laicizmit, i cili në shekullin XIX depërtoi në shtresat e arsimuara dhe i hapi rrugë të gjërë kalimit në marksizëm. Në vigili të revolucionit, besimi ishte zhdukur në mjediset e shkolluara. Ndërsa tek më pak të shkolluarit u cenua dhe u cingua.

Po Dostojevski, që gjykonte sipas mllëfit të revolucionit frëng ndaj Kishës, nxirrte përfundimin: "Revolucioni duhet të fillojë domosdoshmërisht me ateizmin". Dhe gjërat qëndrojnë pikërisht kështu. Por një ateizëm të organizuar, agresiv, si ai i marksizmit, bota nuk kishte njohur kurrë ndonjëherë. Në sistemin filozofik dhe në thelb të psikologjisë së Marksit e të Leninit, urejtja kundër Zotit përbën shtytshën fillore që u paraprin të gjitha projekteve të tyre politike dhe ekonomike. Ateizmi militant nuk është një hollësi, as element anësor, as pasojë shtojcë e politikës komuniste, por boshiti i saj qendror. Për të pëmbushur pikësynimet djallëzore, komunizmi duhet të ketë një popullsi pa fe dhe pa atdhe, të shkallmojë si fenë, ashtu edhe kombin. Përndryshe këtë politikë të dyfishtë komunistët e shpallin dhe e praktikojnë gjithkund. Pëlhura e merimangës së atentateve e thurur tani së fundi rreth Papës, tregon se deri në ç'pikë bota ateiste ndjen nevojën t'i verë dinamitin fesë, deri në ç'pikë feja i ngec asaj efektivisht në fy.

Vitet 1920 në Rusi janë një varg i gjatë martirësh: thuasje krejt kleri ortodoks. Dy mitropolitë të pushkatuar; ai i Petrogradit, Veniamini, pat qenë zgjedhur nga gjithë populli. Vetë Patriarku Tihon, pasi kaloi nëpër duart e Çeka-s e të GPU-së, vdiq në rrethana misterioze. Dhjetëra kryepeshkopë dhe peshkopë të vrarë. Dhjetëra-mijëra priftërinj dhe fetër, të cilët çelëstët donin t'i bënin të hiqnin dorë nga feja, u torturuan, vdiqën nën shkopinj, u dërguan në kampe përqendrimi, u internuan në tundrën e shkretët të Detit të Veriut, ku, të plakur, të uritur dhe të pastrehë, u lanë në mëshirë të fatit. Të gjithë këta martirë të krishterë përballuan me guxim vdekjen për hir të besimit, vetëm disa fare të pakta dredhuan dhe u kthyen në renegatë. Dhjetëra milionë njerëzve iu ndalua të hynin në kishë dhe t'i edukonin fëmijët me ndjenja fetare; u burgosën prindërit që t'i shkëputnin më lehtë fëmijët nga krahët e besimit përmes kërcënimeve dhe mashtrimeve. Rrënim i absurd i bujqësisë ruse rreth viteve 1930 që u quajt çulakëzim dhe kolektivizim dhe që u mori jetën 15 milionë fshatarëve, u drejtua me pamëshirë dhe sot mund të thuhet se pati si qëllim të vetëm shkallimin e mënyrës e jetesës tradicionale dhe kombëtare, si dhe për të çrënjosur fenë në fshat. Tjetërsimi i shpirtitve u shtri edhe në Arqipelagun mizor, në të cilin njerëzit dërgoheshin për të mbijetuar për llogari të të tjerëve. Dhe vetëm disa ateistë gjysmë të marrë mundën të vendosin ta venë emrin bri projektit më të fundit që synon masakrimin e vetë natyrës ruse: përmbytjen e Veriut, ndryshimin e rrjedhës së lumenejve, turbullimin e jetës të Oqeanit Arktik, devijimin e ujërave drejt trevave jugore, të cilat kantiere të tjera të mëdha të komunizmit, jo më pak absurde, i kanë hedhur

tanimë në greminë. I shtrënguar nga nevoja për të bashkuar të gjitha forcat kundër Hitlerit, Stalini i hyri një lojë cinike me Kishën dhe këtë lojë mashtruese, e zgjatur nga inskenimet dhe propaganda e zhurmshme e paguar mirë, Perëndimi e mori përmonedhë të mirë. Por se deri në ç'pikë e urren fenë komunizmi, mund të gjykoni pas shembullit të më liberalit ndër udhëheqësit e tij, Hrushov, i cili, teksa vendosi të ndërmanë disa hapa substancialë drejt liberalizimit, rigjeti tërë zellin e çmendur të Leninit në asgjësimin e fesë.

Por, ndryshe nga ç'pritej - në atë vend me kisha të rrafshuara, ku ateizmi ngadhënjën dhe është i papre prej treçerek shekulli, ku peshkopët poshtëroheshin aq sa të mos kenë më vullnet, ku simbolet e dukshme të Kishës nuk tolerohen përveçse për qëllime propagandistike në Perëndim, ku edhe sot e kësaj dite besimi fetar përbën krim dhe të çon në kamp përqendrimi, ku madje edhe në kampe hidhen në burg ata që mbledhen për t'u lutur në ditën e Pashkëve... - tradita e krishterë i ka bërë ballë nivelimit të tomos komuniste.

Megjithëse, i imponuar nga pushteti, ateizmi ka bërë tek në kërdinë duke tjetërsuar miliona shpirtit, kemi gjithashtu edhe miliona besimtarë të tjerë ende të detyruar të heshtin dhe, ashtu siç ndodh shpesh në raste përndjekshme dhe vuajtjesh, ndjesia e Zotit ka shënuar në vendin tim një thellësi tejçuese.

Në këtë fakt shohim shkëndijat e para të shpresës: Më kot fryhet komunizmi me raketa e tanke, më kot arrin ende suksese në pushtimin e planetit; ai është i dënuar të mos e mposhtë kurrë krishterimin. Perëndimi nuk e ka njohur ende dyndjen komuniste, feja këtu është e lirë.

Por itinerari i tij historik po arin sot në tharjen e ndjenjës fetare. Edhe ai ka njohur tronditje të njëpasnjëshme, luftëra fetare të përgjakshme, sfida. Dhe duke filluar me Mesjetën e vonë, ai, shkallë-shkallë - fakt i pakundërshtueshëm - është gëllitur nga shekullarizmi. Por, për besimin, jo kërcënimin i një shfarosjeje nga jashtë, por i një anemie të brendshme mund të ishte edhe më i rëndë. E pabesueshme: në Perëndim nocioni i kuptimit të jetës është brejtur gjatë dekadave për t'u katandisur në vetëm "fitoren" e lumturisë, të cilën shtetet janë ngutur ta përfshijnë në kushtetutat e tyre. Jo vetëm duke filluar me këtë shekull nocionin Mirë dhe Keq janë vënë në lojë duke u mënjanur me shkathtësi nga përdorimi i përditshëm në dobi të dënglave pa të ardhme mbi klasat apo partitë. Kësajsoj na vjen turp tani t'u kthehemi sërish koncepteve të përherëshme, na vjen turp të pranojmë që e keqja është ngulitur në zem-

rat e njeriut përpara se të depërtojë në sistemet politike, por askujt nuk i vjen turp t'i bëjë lëshime të plota çdo ditë së keqes dhe në pjerrinën e këtyre lëshimeve, gjatë një breznie, Perëndimi është duke rëshqitur në mënyrë të pakthyeshme në humnerë. Shoqëritë perëndimore po e humbin gjithnjë e më shumë substancën e tyre fetare dhe po e hedhin me shpejtësi rininë në prehrin e ateizmit. Mos duhen, vallë, shembuj të tjerë mizorë? Shikoni Shtetet e Bashkuara, që gjithsesi mbahen si një nga vendet më fetare të botës, por ku shfaqet një film që fyen Krishtin apo ku një gazetë me jehonë në shkallë kombëtare boton një karikaturë të pacipë të Shën Mërisë! Kur të gjitha të drejtat formale i ke të gjera, ç'ke që bën pafytyrësira? Në rrethana të tilla, përse u dashka të pakësohet zjarri i urrejtjes, qoftë ajo raciale, klasore apo, më e pamëshirshme, ajo ideologjike? Ajo bren kësajsoj shumë shpirtit. Mësuesit ateistë e edukojnë sot rininë me urejtjen ndaj shoqërisë së tyre. Por në këtë kritikë anashkalohet fakti që veset e kapitalizmit janë vese me karakter njerëzor, por që kanë marrë revanë bashkë me të drejtat e tjera të njeriut; se nën komunizëm (që përgjon nga afër të gjitha trajtat e modëruara të socializmit që nuk janë aspak të qëndrueshme), të njëjtat vese nuk njohin as fre e as kontroll në të gjithë ata që kanë një fije pushtet (përsa i përket pjesës tjetër të popullsisë, ajo ka mbërritur me të vërtetë në barazi, por barazi në skllavëri e varfëri). E nxitur paprerë, kjo urrejtje po ngadhënjën sot në atmosferën e botës së lirë; zgjerimi i lirive individuale, miqja e fitimeve në nivel social, madje edhe ajo e konfortit, nuk bëjnë gjë tjetër përveçse në mënyrë paradoksale e shtojnë këtë urrejtje të verbër. Shoqëritë e zhvilluara të Perëndimit dëshmojnë sot se shpëtimi i njeriut nuk varet nga begatia materiale dhe as nga suksesi i bizneseve. Kjo urrejtje e nxitur pareshtur shtrihet mbi çdo gjë të gjallë, madje mbi vetë jetën, mbi ngjyrtat dhe tingujt e saj, mbi trajtat e saj, e trupit njerëzor, ndërsa arti i vërtetë i shekullit XX humbet nga kjo urrejtje e përbindshme, sepse pa dashuri, arti është shterp. Në Lindje arti ka rënë ngaqë është pëmbysur e shkelur me këmbë; në Perëndim ai ka rënë vetiu me qenëse është vërsulur drejt kërkimesh cerebrale dhe pretencioze, ku njeriu synon jo të pasqyrojë Zotin, por t'ia zërë vendin Atij. Edhe një herë konstatojmë me këtë rast rezultatin e rëndomtë të një procesi universal, përkimin e rezultateve të shënuara si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje. Dhe sërish një arsye e vetme për të gjitha këto: "Njerëzit e kanë haruar Zotin". Përballë trysnisë së ateizmit universal, be-



simtarët janë të përçarë, shumë syresh janë të çorientuar. Por bota e krishterë apo ajo që ka qenë bota e krishterë do të bënte mirë të mos e harrojmë shembullin e Lindjes së Largme. Pata rastin tani së fundi të konstatoj se në Japoni apo në Kinë e lirë, megjithëse konceptet fetare janë më të larme, shoqëria dhe rinia, me lirinë e zgjedhjes të barabartë me atë të Perëndimit, janë më pak të prekura nga fryma shkatërruese e laicizmit. Ç'të flasim për ndarjen midis feve të ndryshme kur vetë krishterimi është kaq i copëzuar! Vitet e fundit Kishat kryesore të krishtera kanë bërë disa hapa drejt pajtimit. Por këto hapa janë tepër të ngadaltë, bota vrapon drejt gremisë me një shpejtësi njëqind herë më të madhe. Edhe nëse nuk pritet që këtu një shkrije e Kishave, as ndonjë modifikim i dogmës, por një rezistencë e përbashkët ndaj ateizmit, progreset janë ende tepër të pakta. Sigurisht që ekziston një lëvizje e organizuar për ribashkimin e Kishave, por e çuditshme. Në dukje më i shqetësuar për suksesin e lëvizjeve revolucionare në vendet e Botës së Tretë, Këshilli Ekumenik i Kishave bën veshin të shurdhër ndaj përndjekjeve fetare atje ku ato janë më sistematisht: në BRSS. Është e pamundur të mos i shohë; por, për shkaqe politike, ai parapëlqen të bëjë një sy qorr e të mos ndërhyjë. Atëherë ç'mbetet nga krishterimi?

Me hidhërim të thellë duhet të them këtu (nuk mund të hesht) se paraardhësi im, titullari i vitit të kaluar i këtyre Çmimit (predikuesi baptist Billy Graham, sh. ynë) iu bë krahu publikisht gjenjshtrës komuniste në muajt e marrjes së Çmimit, duke deklaruar, megjithëse duket sheshit, se nuk paska vënë re përndjekje fetare në BRSS. Qielli e gjykoftë para të gjitha viktimave të vrara apo të shtypura!

Në një shkallë më të gjërë shohim sot se,

pavarësisht nga manevrat politike nga më dinaket, litari po shtrëngohet rreth fytyrës të njerëzimit, çdo dekadë përherë e më pamëshirshëm, dhe nuk ka rrugëdalje për kërkënd, kurrkund, as atomike, as politike, as ekonomike, as ekologjike. Kështu të paktën duket se qëndrojnë punët.

Përballë maleve dhe greminave të ngjarjeve botërore, mund të duket qesharake dhe e tejkaluar të rikujtojmë faktin që gjithsesi çelësi themelor i ekzistencës ose i asgjësimit tonë ndodhet në zemrën e secilit prej nesh, në parapëlqimin që ka çdonjëri veçmas për Të Mirën apo Të Keqen konkrete. Por, sot, njëloj si edhe dje, ky çelës mbetet më i sigurt. Teoritë sociale premtuese kanë dështuar dhe na kanë lënë në udhëkryq. Natyrisht njerëzit e lirë të Perëndimit duhet të kuptojnë se rreth tyre janë grumbulluar shumë gjenjshtrës që livadhisin lirshëm dhe të mos pranojnë të qëndrojnë kaq pasivë ndaj tyre. Është e kotë të kërkohet një rrugëdalje për gjendjen e botës pa e kthyer ndërgjegjen në pendesë drejt Krizës së tjetër; asnjë rrugëdalje tjetër nuk kemi për të pasur dhe nuk kemi për të gjetur. Por tepër të pafat janë mjetet që kemi rezervuar për këtë. Para së gjithash duhet parë e keqja e tmerrshme - jo ajo që do të kishin bërë armiqtë e vendit - sidomos në gjitë shoqërive më të lira e më të zhvilluara, sepse atje e kemi bërë vetë ne, me dëshirë. Po qe se litari shtrëngohet përditë e më shumë, kjo u detyrohet egoizmit dhe moskolektarjes sonë. Le të vetë-pytemi: a nuk janë, vallë, mashtruese idealet e epokës sonë? Apo terminologjia në modë dhe e mbushur me kaq siguri? Nga kjo burojnë këto zgjidhje të sipërfaqshme për ndreqjen e situatës. Para se të jetë tepër vonë, ato duhen rishqyrtuar, veç e veç, me një këqytje të pastër. Zgjidhja e krizës nuk gjendet në rrugë e rrahura të koncepteve për të cilat flitet përditë.

Jeta jonë konsiston jo në kërkimin e suksesit material, por të progresit shpirtëror të denjë për këtë emër. Krejt ekzistenca jonë nuk është gjë tjetër përveçse një etapë e ndërmjetme drejt një jete më të lartë: bëhet fjalë për të mos u gremisur nga ky stad dhe për të mos mbetur të shterpë në të. Ligjet fizike dhe fiziologjike nuk do të na i zbulojnë asnjëherë të vërtetën e padyshueshme që në mënyrë konstante dhe përditë Krijuesi merr pjesë në jetën e secilit prej nesh, se Ai na jep me besueshmëri energjinë për të ekzistuar. Atëherë kur kjo ndihmë nuk na jepet më, vdesim. Pjesëmarja e Tij në jetën e krejt planetit është më e madhe dhe lipset që ne të ngjizemi me të në këtë epokë të zymtë dhe kërcënuese. Shpresat e pathemelta të dy shekujve të fundit na çuan në kurgjë. Vdekjes atomike apo ndonjë tjetër, mund t'i kundërvemë vetëm kërkimin këmbëngulës të dorës së ngrohtë të Perëndisë, të cilën, me mospërfilljen tonë, e kemi larguar nga vetvetja. Vetëm atëherë sytë tanë do të hapen mbi këtë shekull fatkeq XX dhe duart tona do të zgjaten për t'ia ndrequr gabimet. Asgjë tjetër nuk do të mund të na mbajë për të mos u vithisur poshtë e më poshtë: nuk na ka mbetur më shumë se të gjithë mendimtarët e Dritave.

Të pesë kontinentet tanë janë kapur në këtë vorbull. Por orvatje të tilla nxjerrin në pah edhe virtyt më të larta të shpirtit njerëzor. Po të shuhemi, po të bëjmë të shuhet kjo botë, faji ka për të qenë vetëm yni.

*Radio Evropa e Lirë

*Marrë nga Haemus

Shkrimtari i Gulagut*

Aleksandër Solzhenicini, fituesi i çmimit Nobel në letërsi në vitin 1970, për rusët do mbetet ndërgjegjja e kombit. Kurse, për lexuesit e tij në botë, shkrimtari që nxori në dritë krimet e regjimit të Stalinit dhe bëri të njohur tmerrin e gulagëve. Ai u lind më 11 dhjetor 1918 dhe vdiq më vitin 2008. Gjiganti i letrave ruse Aleksandër Solzhenicini, disidenti që në mënyrë të palodhur nxori në pah krimet në kampet sovjetike të përqendrimit, shkroi "Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit", libri i shkruar mbi përvojën të vjetër të Solzhenicinit si i burgosur politik. Ajo ishte vepra e parë letrare që dënonat drejtpërdrejt Gulagun sovjetik. Libri i publikuar në vitin 1962 dhe pa dritën e botimit falë udhëheqësit sovjetik të kohës Nikita Hrushov, i cili donte të nxirrte në shesh disa nga krimet e Stalinit. Të dyja botimet e librit u shitën sa hap e mbyll sytë. Por liberalizmi i Hrushovit duket se zgjati pak, pasi në vitin 1964 në krye të Bashkimit Sovjetik erdhi Leonid Brezhnëvi. Kur Solzhenicini morri çmimin Nobel në letërsi në vitin 1970 autoritetet e regjimit nuk e lejuan të udhëtonte në ceremoninë e Nobelit në Stokholm. Më pas, Solzhenicini punoi për trilogjinë "Arqipelagu Gulag". Në vitin 1974, shkrimtarit iu morr nënshtetësia ruse dhe u largua në mërgim. Po në këtë vit Solzhenicini mundi të marrë nga duart e mbretit të Suedisë Karl Gustav çmimin Nobel për letërsi. Pavarësisht mërgimit në ish Bashkimin Sovjetik njerëzit e lexonin fshehurazi Solzhenicinin. Solzhenicini, pas largimit nga Rusia në vitin 1974, qëndroi për një kohë të shkurtër në Zvicër dhe më pas u vendos në Vermont të Shteteve të Bashkuara.

Jeta në Perëndim nuk ishte ajo e dëshiruara për shkrimtarin, pasi për të njerëzit ishin zhytur në kotësi dhe konsumerizëm. Ndërkohë në vendin e tij të origjinës njerëzit e përdornin Solzhenicinin si mjet jo vetëm liric, por edhe për të mësuar të vërtetën rreth Bashkimit Sovjetik. Me ardhjen në pushtet të Mikhail Gorbacovit, Solzhenicini iu rikthyer nënshtetësia sovjetike dhe akuzat për tradhti iu hoqën. Solzhenicini, i cili gjithmonë kishte thënë se donte të vdiste në Rusi, filloi të projektonte kthimin. Pas 20 vitesh mërgimi shkrimtari i rikthye në atdhe si hero në maj të vitit 1994. Ndër gjërat e para që bëri ishte nderimi për miliona të vdekurit në gulagët sovjetikë. Me tu vendosur në Moskë, Solzhenicini vazhdoi të vepronte si ndërgjegjja e Rusisë, duke bërë thirrje për rikthimin e vlerave ruse bazuar në besimin ortodoks.

Solzhenicini ishte plotësisht i pakënaqur me kapitalizmin që po zhvillohej në Rusi.

"Ajo çfarë ne kemi sot nuk mund të quhet demokraci. Sot kemi një oligarki dhe pushtetin e vendosur në një rreth të mbyllur", tha Solzhenicini para Dumës ruse në dhjetor të vitit 1994.

Ardhjen në pushtet të Putinit, ish pjesëtar i KGB-së, shkrimtari e pa me shqetësim, por më vonë mirëpriti hapat e Putinit kundër oligarkëve dhe rivendosjen e kontrollit të shtetit mbi burimet natyrore.

Megjithatë raportet e tij me Kremlinin asnjëherë nuk ishin të qarta. Ndryshe nga Kremlinin për qytetarët rusë ai ishte ndërgjegjja e kombit.